

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, sipas gjyqtarit, Halil Zahiri, me Ass. Ligjor Baki Sylejmani, dhe s. juridike Shefinaze Sahiti, në çështjen juridiko-civile të paditësit, U. Z., nga Gj., rr. ..., nr. ..., sipas të autorizuarit F. S., Jurist, nga Gj., kundër të paditurve, S. K. dhe G. K., nga Gj., rr. ... nr. ..., ky i fundit përkohësisht i përfaqësuar, prej av. H. A. nga Gj., për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, në seancën kryesore dhe publike të mbajtur më dt.12.12.2016 bie këtë

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkespacia e paditësit, U. Z., kundër të paditurve, S. K. dhe G. K., nga Gj. dhe **VËRTETOHET** se paditësi është pronarë i pasurisë së paluajtëshme përkatësisht ngas.kad.nr. P-70403013-...-..., në sipërfaqe prej gjithësejt 0..... ha, me kulturë pronë private-arë e kl. 3, e cila gjenden në v.q. ,,..., e regjistruar në bashkpronësi për nga 1/2 e pjesës ideale, në emër të të paditurve, sipas Çertifikatës nga lënda nr....-..., ZK Gj. /e lëshuar më dt.30.09.2016, nga DGJKP, në Gj., në veprimin juridik, kontratës verbale dhe mbajtjes së ligjshme dhe në mirëbesim.

II. DETYROHEN të padituri t ia njohin dhe pranojnë paditësit të drejtën e pronësisë për pasurinë e paluajtëshme, ashtu që paditësi, U. Z. të regjistrohet si pronarë juridik i pasurisë kontestuese, në DGJKP, në Gjilan, këtë në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me vërejtje të përbarimit të detyruar.

III. Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, gjykata vendosi, sejcila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësitësi, U.Z., nga Gj., kishte konfirmuar se në vitin ...-..., i ndjeri babai im, H. Z. e kishte bler pasurinë kontestuese prej të vejës, F. K., nëna e të paditurve dhe e veja e të ndj. N. K., për çmimin kontraktues në dinarë të atëhershëm, për çdo metër katrore në shumën prej 3 DM, të shëndrruara në dinarë të atëhershëm, sipas kontratës verbale për shitblerjen e pasurisë së paluajtëshme dhe mbajtjes së ligjshme dhe në mirbesim mbi 30 vite.

Pas pagesës së çmimit kontraktues nga blerësi i atëhershëm, shitësja F. K., ia kishte dorëzuar të ndjerit H. Z. dhe familjes së tij, pasurinë kontestuese, në shfrytëzim përkatësisht në pronësi faktike të papenguar, nga shitësja, familjarët e sajë tani të paditurit, apo personat tjerë.

Në mes palëve kontraktuese ishin përmbushur detyrimet kontraktuese dhe paditësi pasurinë kontestuese e kan në posedim-shfrytëzim të ligjshëm, me mirëbesim, nga viti 1979 e tutje, i papenguar nga të paditurit, familja e tij apo personat tjerë.

I autorizuari paditësit, F. S., jurist, nga Gj., në seancën kryesore të mbajtur më dt.12.12.2016, dhe seancat tjera, deklaroi se mbetej pranë padisë-precizimit të padisë, i propozonë gjykatës që në tërësi ta aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë dhe ti detyroi të paditurit që pasurinë kontestuese t ia evidentoi në emër të paditësit, në regjistrin e DGJKP të Gjilanit. Gjykatës i ka propozuar të administrohen të gjitha provat nga lënda, të

dëgjojen, eksperti gjodet, dëshmitarët, Sh. R., K. M., H. A., i padituri U. Z. dhe paditësi, S. K. të gjith, nga Gj..

Të paditurit, S. K. dhe G. K., në fillim në adresë të pakonfirmuar, të përfaqësuar prej av. H. A., nga Gj., i cili deklaroi qëndroi pran përgjigjes në padi të ushtruar kësaj gjykate, ndërsa pajtohet me propozimin e paditësit për administrimin e provave, dëgjimin e dëshmitarëve, palëve ndërgjyqëse dhe ekspertit gjeodet, ndërsa pas administrimit të provave dhe skicës me konstatim të hartuar, nga vendi i ngjarjes e rezervoi të drejtën të deklarohem lidhur me çështjen kontestuese.

1. Paditësi, U. Z., nga Gj., deklaroi, në viti ...-..., babai im i ndj. H. Z., pasurinë kontestuese e kishte bler prej nënës së të paditurve, për Çmimin kontraktuese në dinarë të atëhershëm, pasi e kishte paguar-përmbushur në tërësi Çmimin kontraktuese familja e të paditurve ia kishte dorëzuar në shfrytëzim dhe pronësi faktike pasurinë kontestuese, blerësit të atëhershëm, H. Z. dhe familjes së tijë.

E njoftoi gjykatën se të paditurit dhe familja e tijë as njëher nuk na kan penguar blerësin e atëhershëm, paditësin dhe familjen e tijë, në shfrytëzimin e pasurisë kontestuese.

2. I padituri, S. K., nga Gj., pasi i ka dëgjuar dëshmitarët dhe ekspertin gjeodet , nga Vendi i ngjarjes, deklaroi në tërësi e ka pranuar kërkespadinë e paditësit duke pohuar se pasurinë kontestuese i ndjeri H. Z., e ka bler sipas ndërmjetsimit të Kusheriri tim dhe ate M. K., pasi babai im N. K. kishte vdekur, ndërsa e veja F. K., nëna ime i ka pranuar shumën e parave në emër të pagesës së Çmimit të shitblerjes së pasurisë kontestuese, dhe ate para ishte bërë për vlerën në çdo metër katrore shuma për 3 DM, të llogaritura në dinarë të atëhershëm, ashtu që blerësi i atëhershëm në tërësi e ka paguar Çmimin kontraktues, por nuk e ka regjistruar dhe bartuar në emrin e tij në DGJKP, në Gjilan edhe tani paditësi, U. Z. pasurinë kontestuese nuk e ka bartuar në emrin e tij, për çka neve na është pamundësuar të rregullojm pension dhe ne si familje ishim të dëmtuar pasi ishte toka në emrin tonë dhe nuk kemi patur mundësi ta realizojm pensionin.

E njoftoi gjykatën se paditësi dhe i ndjeri babai i tij, me familje mbi 30 vite e ka punuar dhe shfrytëzuar pasurinë kontestuese, të pa penguar nga ne të paditurit, familja jon apo personat e tretë se të njëjtën pasuri e ka paguar në tërësi dhe familja ime ia ka dorëzuar pasurinë kontestuese në shfrytëzim të pa penguar.

Në seancën kryesore të mbajtur më dt.12.12.2016, përveq të paditurit S. K., jan dëgjuar paditësi, eksperti gjeodet dhe dëshmitarët e propozuar si vijoi:

3. Eksperti gjeodet I. J., nga Gj., deklaroi, qëndroi në tërsësi pran konstatimit me skicë të hartuar nga vendi i ngjarjes dhe jam i gatshëm të përgjigjem në pyetjet e gjyqtarit të çështjes dhe palëve ndërgjyqëse. E njoftoi gjykatën se nga gjendja ekzistuese është bërë regjistrimi nga DGJKP, më parë ashtu që e ka regjistruar siperfaqen prej 0. ..., ... ha, ndërsa duhet të regjistrohet siperfaqja reale sa ekziston nga vendi i ngjarjes prej 0. ..., ... ha, pra siparfaqja prej 0. ..., ... ha, nuk ekziston. Palët ndërgjyqëse nuk kishin vërjejtje në skicen me konstatim të hartuar nga vendi i ngjarjes.

4. Dëshmitari, Sh. R., nga Gj., i moshës ... vjeqar, deklaroi paditësi, U. Z., me familjen e tijë e shfrytëzon pasurinë e paluajtëshme kontestuese mbi 30 vite dhe e ka punuar i pa penguar nga të paditurit, familja e tijë apo personat e tretë.

E njoftoi gjykatën se pasurinë kontestuese babai i paditësit e kishte bler para 30 viteve, në dinar të atëhershëm, këtë rrethan e kam dëgjuar nga palët ndërgjyqëse dhe fqinjët e lagjës ku jetoi.

5. Dëshmitari, K. M., nga Gj., deklaroi paditësi, U. Z. me familjen e tijë e shfrytëzon pasurinë e paluajtëshme kontestuese mbi 30 vite dhe e ka punuar i pa penguar nga të paditurit, familja e tijë apo personat e tretë.

E njoftoi gjykatën se pasurinë kontestuese babai i paditësit e kishte bler para 30 viteve, në dinarë të atëhershëm, këtë rrethanë e kam dëgjuar nga palët ndërgjyqëse dhe fqinjët e lagjës ku jetoi.

6. Dëshmitari, H. A., nga Gj., deklaroi paditësi, U. Z. me familjen e tijë e shfrytëzon pasurinë e paluajtëshme kontestuese mbi 30 vite dhe e ka punuar i pa penguar nga të paditurit, familja e tijë apo personat e tretë.

E njoftoi gjykatën se pasurinë kontestuese babai i paditësit e kishte bler para 30 viteve, në dinarë të atëhershëm, këtë rrethanë e kam dëgjuar nga palët ndërgjyqëse dhe fqinjët e lagjës ku jetoi.

Në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata ka analizuar deklaratat e palëve ndërgjyqëse, dëshmitarëve dhe i ka administruar të gjitha provat dhe shkresat e lëndës si vijon;

- Lexohet dhe administrohet, Çertifikatës sipas lëndës nr. ...-2014, e lëshuar më dt. 06.06.2014, nga DGJKP, në Gjilan. Nga kjo provë gjykata konstatoi se ngas.kad.nr. P. 70403013- ...- ..., ishte regjistruar në bazë të vendimit mbi trashëgiminë T.nr. .../2006, të lëshuar më dt.27.09.2006, nga Gjykata komunale në Gjilan, në emër të S. K., nga Gj..

- Lexohet dhe administrohet, Çertifikatës sipas lëndës nr...-2016, e lëshuar më dt. ... 2016, nga DGJKP, në Gjilan. Nga kjo provë gjykata konstatoi se ngas.kad.nr. P. 70403013- ...-..., ishte regjistruar në bazë të Kontratës mbi Dhuratën nr. .../2006, të vërtetuar më dt.2006, nga Gjykata Komunale në Gjilan, në bashkpronësi për nga 1/2 e pjesës ideale në emër të S. K. dhe G. K., nga Gj..

- Lexohet dhe administrohet, konstatimi me skicë të hartuar, nga vendi i ngjarjes më të dt.01.12.2016, prej ekspertit gjeodet, Ibush Jashari, nga Gjilani. Nga kjo provë gjykata konstatoi se gjendja juridike nuk përputhet me gjendjen faktike dhe parcelës kontestuese dhe mungon sipërfaqja prej 0.01,19 ha.

- Lexohet dhe administrohet, Aktvendimi i dt.1991, Aktgjykimi P.nr. .../2008, i dt.2011, Fleta poseduese nr. ..., e lëshuar më dt. ...1991, nga Drejtoria e përgjithshme kadastrale, Komuna në Gjilan.

Në fjalën përfundimtare paditësi dhe i autorizuari paditësit jur. F. S., deklaruan se nga të gjitha provat e administruara, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, ekspertit gjeodet dhe dëshmitarëve, është vërtetuar fakti se babai i paditësit dhe paditësi me familjen e tijë nga viti 1979-1980 pasurinë kontestuese e kishte në shfrytëzim dhe posedim i pa ndërprer nga të paditurit me familje, personat e tretë apo megjenikët, që e kishte blerë prej nënës së të paditurve e veja e parardhësit të pronës kontestuese, për çmimin në dinarë të atëhershëm, i propozoi gjyktës që kërkespadinë e paditësit ta aprovoi në tërësi si të bazuar, nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i paditësve av. H. A. dhe i padituri S. K., nga Gj., njëzërit deklaruan e prenojmë kërkespadinë e paditësit pasi ai pasurinë kontestuese e ka në shfrytëzim dhe posedim të ligjshëm dhe me mirëbesim i pa penguar nga të paditurit, familja e tyre dhe personat e tretë mbi 30 vite, andaj i propozojnë gjykatës që të vendos në bazë të Ligjit me aktgjykim meritor, nuk i kërkojmë shpenzimet e procedurës.

Lidhur me këtë gjykata vërtetoi gjendjen faktike se ka ekzistuar raporti juridiko civil mes palëve kontraktuese sipas punës juridike, kontratës verbale mbi shitblerjen e pasurisë së paluajtëshme për çka edhe pala e paditur e ka pranuar kërkespadinë si të bazuar, se ishte lidhur kontrata verbale për shitblerjen e pasurisë të paluajtëshme, ndërsa gjykata në bazë të nenit 73 të LMD-ës, e konvalidoi kontratën e tillë, si punë të vleshme juridike.

Në bazë të nenit 28 të LTHMJP, paditësi mbi 20 vite e mban pasurinë kontestuese, e ka në posedim-shfrytëzim të ligjshëm dhe me mirëbesim, i pa penguar nga të i paditurit, familja e tyre apo personat tjerë dhe nga baza e prashkrimit fitues paditësit i njihet e drejta pronësisë për pasurinë kontestuese.

Nga të cekurat më lart, në bazë nenit 73 të LMD-ës, nenit 28 të LTHMJP, nenit 143 par.1, të LPK-ës, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, sejcila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Gjyqtari
Mr.sc. Halil Zhiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të të njejtit. Ankesa dorëzohet në kopje mjaftuara përmes kësaj Gjykate.